



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBETARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Filozofi

• *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	A	C	A	B	D	A	D	A	B	B

• *Pyetjet me zhvillim*

Shënim:

- Në skemën e vlerësimit të testit, për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta. Nxënësi do të marrë pikët e merituar edhe nëse ai ka dhënë përgjigje me fjalë të tjera por që janë brenda kontekstit të përgjigjes së saktë.
- Në pyetjet me zhvillim, ku kërkohen dy, tre apo katër nga të gjitha përgjigjet e sakta të mundshme, në rast se nxënësi ka dhënë aq përgjigje të sakta sa i kërkohen nga pyetja, atëherë atij do t'i jepen të gjitha pikët maksimale me të cilat është vlerësuar pyetja.
- Nxënësi do të marrë aq pikë sa është vlerësuar pyetja edhe në rast se ai ka dhënë më shumë përgjigje të sakta nga sa i kërkohen.

11. Nga filozofia e Aristotelit përshkruani:

a) kritikën e tij ndaj teorisë së ideve të Platonit

2 pikë

-mban qëndrim kritik.

-idetë jashtë sendeve, apo të ndara prej tyre, nuk mund të jenë shkaku i tyre.

-të pranosh dy realitete të ndara, pra një botë të veçuar idesh, veç asaj shqisores, të sendeve, është e padobishme.

-idetë e palëvizshme nuk mund të shpjegojnë lëvizjen, veti e botës shqisore.

b) virtytin

2 pikë

-njeriu dallon nga krijesat e tjera si qenie e arsyeshme, ndaj dhe lumturia duhet të lidhet me ushtrimin dhe përsosjen e arsyes. Këtu qëndron edhe virtyti.

- ka virtyte

-etike ose të sjelljes praktike, nënkuptojnë një lloj fitoreje të arsyes mbi instiktet. Ato konsistojnë në gjetjen e mesit midis dy skajeve të kundërta të sjelljes, që përbëjnë vesin. P.sh., kurojo është virtyt, e mesmja midis guximit të çmendur dhe frikës, bujaria-midis prishjes së çmendur dhe kopraxisë,

-dhe të intelektit. – Përsosja e shpirtit racional përbën realizimin e virtyteve të intelektit
Midis virtyteve vlerëson drejtësinë

12.

3 pikë

a) dëshmia e parë (kriteri i parë) e kënaqësisë dhe e vuajtjes

b) gjërat e padukshme –boshllëku, atomi, pafundësia

c) kriteri i dytë i së vërtetës

13. 3 pikë
- lëvizja- Zoti është lëvizësi i palëvizshëm
 - shkaku – Zoti është shkaku i parë veprues
 - qenia e domosdoshme- Që të ekzistojnë qeniet e mundshme, duhet një e domosdoshme, që shkakun e domosdoshmërisë e ka vetëm te vetja e saj. Ky është Zoti.
 - përsosmëria- Krahasimi i vlerave është i mundur vetëm në saje të asaj që mishëron vlerën më të plotë, më të përsosur, të asaj që vetë është absolutisht e mirë, fisnike dhe e vërtetë. Kjo qenie me vlerën më të lartë e të përsosur, është Zoti.
 - Rregulli i universit – gjërat sillen në një mënyrë të paracakruar, për të arritur funksionet dhe qëllimet e tyre. Si të pandërgjegjshëm që janë, ato nuk mund t'i realizojnë qëllimet pa u orientuar nga një qenie e ndërgjegjshme si shigjeta e drejtuar nga shigjetari.
14. Krahasoni kreun e shtetit ideal të: 2 pikë
- Platonit - republika mbetet projekti i shtetit ideal, ku qeveris dija, e mishëruar në figurën e filozofit, me përparësi ndaj ligjit.
 - Kampanelës - Me anë të dialogut, ai e paraqet teorinë e tij ideale për formën më të mirë të shtetit. Përshkruan një ishull ku dallon tempulli dedikuar Diellit. Por diell quhet edhe prifti – Metafiziku, që qëndron në krye të qytetit, i cili ka pushtet absolut, civil dhe fetar. Në figurën e tij mishërohet i dituri, filozofi.
15. Përshkruani tre momente nga parimi i traktatit etik të Dekartit, mbi sundimin e vetvetes. 3 pikë
- Ndiq ligjet, zakonet dhe fenë e vendit tënd dhe përvetëso pjesën më të arsyeshme të tyre.,
 - Ji i qëndrueshëm në veprimet e tua, megjithëse disa gabime janë të pashmangshme
 - Sundo vetveten dhe varu më shumë nga mundësitë e tua se sa nga gjërat e jashtme.
16. Shpjegoni tre momente të rëndësishëm të kuptimit liberal të politikës nga Hobsi. 3 pikë
- Atje ku nuk ka shtet dhe ligj, nuk mund të flitet për padrejtësi e drejtësi të mirëfilltë.
 - Dallon të drejtën prej ligjit
 - Arsyeja i çon njerëzit të bashkohen në shtet.
 - Roli i sovranit është të veprojë si arbitër në zgjidhjen e konflikteve dhe të vendosë ligje të drejta.
 - Sovrani absolut i bën njerëzit të lirë nga kisha dhe të lirë në mendimet e tyre.
17. 3 pikë
- klima
 - feja
 - pozita gjeografike
 - natyra e regjimeve politike
 - numri i popullsisë etj.
18. 2 pikë
- lidhja shkak-pasojë është lojë psikologjike e zakonit
 - mënyrat e mendimit njerëzor paraqiten si lidhje e ideve, që përfshin algjebërën dhe gjeometrinë, parimet e së cilës zbulohen vetëm nga mendja, ose si fakte që nxirren nga realiteti dhe nuk kanë kontradikta.
 - vlerësimi i njohjes shqisore
 - roli i përshtypjeve
 - perceptimet janë burim i njohjes –
 - nuk ka ide të përgjithshme, por ato janë veçse ide të veçanta
 - kujtesa
 - imagjinata

19.

3 pikë

- a) ekzistencializmi
- b) fenomenologjia
- c) pozitivizmi
- d) utilitarizmi
- e) strukturalizmi
- f) psikanaliza
- g) pragmatizmi
- h) intuitivizmi

20.

- a) mbinjeriun - Njeriu është e vetmja qenie e aftë ta bëjë vetveten ashtu siç dëshiron të jetë. Përpyekja e tij për përsosje, e çon atë në kërkim të mbinjeriut. Edhe vetë mbinjeriu nuk është i përsosur. Edhe te ai ka nevojë për përsosje. Prandaj mbinjeriu është ideal. Ai afirmon individualitetin e vet, lirinë e tij kundrejt vlerave tradicionale dhe shpalos në mënyrë pozitive vullnetin për fuqi. 2 pikë
- b) krijimin e vlerave të reja – Niçja kërkon një kthim te vlerat tradicionale. Duket sikur ai i mohon të gjitha vlerat e trashëguara të moralit, fesë dhe filozofisë. Megjithatë Niçja është një nihilist që edhe pohon. Ai propozon një moral me vlera, ku të respektohet individi dhe jo vetëm grupi. Vlerat duhet të ndihmojnë që njeriu të arrijë shkallën më të lartë të zhvillimit të tij si qenie, dhe jo ta gjymtojë atë. 2 pikë